



European Monitoring Centre
for Drugs and Drug Addiction



Standardet e cilësisë evropiane në parandalimin e drogës: një udhëzues i shpejtë

Përgatitur nga

Angelina Brotherhood dhe Harry R. Sumnall

Qendra e Shëndetit Publik, Liverpool John Moores University,
UK

Korrik 2013

Përmbajtja

Parathënia nga EMCDDA	3
Parathënia	4
<i>Në lidhje me standardet e cilësisë</i>	<i>4</i>
<i>Cikli i projektit – tre nivelet e detajeve.....</i>	<i>5</i>
Tabela 1: Etapat e projektit dhe pjesët përbërëse në standardet evropiane të cilësisë në parandalimin e drogës	7
<i>Përdorimi i manualit të standardeve të cilësisë</i>	<i>7</i>
<i>Përdorimi i këtij udhëzuesi të shpejtë dhe listës së kontrollit</i>	<i>8</i>
Standardet dhe lista e kontrollit	11
<i>Vlerësimet e tërthorta</i>	<i>11</i>
<i>Etapa e projektit 1: Vlerësimi i nevojave</i>	<i>14</i>
<i>Etapa e projektit 2: Vlerësimi i burimeve.....</i>	<i>17</i>
<i>Etapa e projektit 3: Formulimi i programit</i>	<i>19</i>
<i>Etapa e projektit 4: Planifikimi i ndërhyrjes.....</i>	<i>22</i>
<i>Etapa e projektit 5: Menaxhimi dhe mobilizimi i burimeve</i>	<i>25</i>
<i>Etapa e projektit 6: Dorëzimi dhe monitorimi.....</i>	<i>29</i>
<i>Etapa e projektit 7: Vlerësimet përfundimtare</i>	<i>32</i>
<i>Etapa e projektit 8. Propagandimi dhe përmirësimet.....</i>	<i>34</i>
Vetë-reflektimi: plani i veprimit.....	36
Materiale të tjera për lexim	37

Parathënia nga EMCDDA

Ky variant i “udhëzuesit të shpejtë” të standardeve të cilësisë evropiane në parandalimin e drogës u përgatit nga Angelina Brotherhood dhe Harry R. Sumnall dhe u financua nga EMCDDA si pjesë e projektit të saj: ‘Përgatitja e përfituesve IPA për pjesëmarrjen e tyre në Qendrën Evropiane të Monitorimit për Drogat dhe Varësinë nga Droga (EMCDDA)’, Projekti Nr. 2011/280–057, i financuar nga Instrumenti i Komisionit Evropian për Asistencën e Para-Hyrjes (IPA). Ajo është bazuar në një manual të EMCDDA mbi çështjet e botuara në vitin 2011.

Qëllimi i udhëzuesit është ofrimi i informacionit praktik mbi standardet e cilësisë së parandalimit të cilat janë të disponueshme jashtë Bashkimit Evropian. Këtu përfshihet një përshkrim i tetë fazave të përfshira në ciklin e parandalimit të drogës, së bashku me një listë kontrollit të vetë-reflektimit e cila mund të përdoret kur planifikohen dhe zbatohen aktivitete parandaluese. Kjo është krijuar profesionistët dhe ata të cilët punojnë në terren.

Ky material do të jetë si fillim i disponueshëm në gjuhën angleze në internet, dhe më pas edhe në gjuhë të tjera, ndërkohë që zhvillohen projektet e bashkëpunimit teknik të EMCDDA.

Dëshirojmë, duke përfituar nga rasti të falënderojmë Angelina Brotherhood dhe Harry R. Sumnall për kontributin e tyre për të paraqitur këtë publikim.

Parathënia

Në lidhje me standardet e cilësisë

Cilësia e Standardeve evropiane në parandalimin e drogës, të botuara si Manuali Nr. 7 nga Qendra Evropiane e Monitorimit për Drogat dhe Varësinë nga Droga (EMCDDA) ⁽¹⁾, ofron kuadrin e parë evropian se si të kryhet parandalimi i drogës në cilësi të lartë. Standardet theksojnë aspektet e mëposhtme të cilësisë në punën parandaluese:

- ndërlidhja e aktiviteteve me popullatën në objektiv dhe politikat (ndër) qeveritare
- përmbajtja ndaj parimeve etike të pranuar
- integriteti dhe promovimi i bazës së provave shkencore, si dhe
- lidhja e brendshme logjike, fizibiliteti dhe mbështetja e projektit.

Standardet e përfshira në manual u krijuan gjatë një projekti dy-vjeçar të bashkë-financuar nga Bashkimi Evropian sipas Programit të Veprimit të Komunitetit në fushën e Shëndetit Publik (2003–08) (Projekti Nr 2007304). Projekti u zbatua nga Partneriteti i Standardeve të Parandalimit, një bashkëpunim multi-disiplinor dhe multi-sektorial i shtatë organizatave në të gjithë Evropën, e drejtuar nga Qendra për Shëndetin Publik në Liverpool John Moores University, UK ⁽²⁾. EMCDDA mbështeti Partneritetin përgjatë procesit krijues dhe ka financuar gjithashtu botimin e standardeve si një manual si dhe krijimin e këtij udhëzuesi të shpejtë.

Udhëzuesi se si të planifikohet dhe ofrohet parandalim efektiv i drogës, në fillim të projektit, ishte në dispozicion vetëm në disa Shtete Anëtare të Bashkimit Evropian (EU). Udhëzuesi në dispozicion ishte i ndryshueshëm në termat e cilësisë së tij, përmbajtje dhe zbatueshmëri, dhe mungonte një kuadër i përgjithshëm evropian për cilësinë në parandalimin e drogës. Rrjedhimisht, cilësia e shërbimeve për parandalimin e drogës shpesh do të ishte në varësi të maturisë së ofruesve individualë të shërbimit ose autoriteteve vendore. Për këtë arsye, projekti kishte për qëllim të përmirësonte politikën dhe praktikën evropiane të parandalimit të drogës duke krijuar një kuadër referues të përbashkët për aktivitetet e parandalimit të drogës.

Udhëzuesi evropian dhe ndërkombëtar i parandalimit të drogës u sistemua dhe u shqyrtua për të krijuar standardet. Në këtë fazë u bë një dallim ndërmjet udhëzuesit që fokusohet në përmbajtjen e ndërhyrjeve ("çfarë") dhe udhëzuesit që fokusohet mbi aspektet formale të punës parandaluese ("si"). Partneriteti vendosi të fokusohet mbi udhëzimin 'si' të bërë parandalimin ⁽³⁾. Nëntëmbëdhjetë grupet e standardeve të cilësisë në përputhje me kriteret specifike të seleksionimit u sintetizuan nëpërmjet një analize cilësore të përmbajtjes për të krijuar draftin e parë. Në fazën e dytë, u bë vlerësimi i rëndësisë, dobisë dhe fizibilitetit të këtyre standardeve draft, në gjashtë vende EU, nëpërmjet anketimeve online dhe grupeve të fokusit. Mbi 400 delegatë të grupeve të ndryshme profesionale dhanë mendimet e tyre mbi draftin e standardeve dhe vunë në dukje barrierat për implementimin. Bazuar në këto konsultime, Partneriteti ripunoi dhe përfundoi standardet dhe krijoi listën e kontrollit të vetë-kontrollit të paraqitur në këtë udhëzues të shpejtë. Informacion i mëtejshëm mbi krijimin e standardeve mund të gjendet në manualin e EMCDDA.

⁽¹⁾ Brotherhood, A., Sumnall H., R. dhe Partneriteti i Standardeve të Parandalimit (2011), *Standardet evropiane të cilësisë për parandalimin e drogës: një manual për profesionistët e parandalimit* Manuali Nr 7 të EMCDDA, Luxembourg. Zyra e Publikimeve të Bashkimit Evropian.

⁽²⁾ Organizatat partnere ishin: ASL e Milano (Itali), Consejería de Sanidad – Servicio Gallego de Salud (Xunta de Galicia) (CS–SERGAS) (Spanjë), Azienda Sanitaria Locale n. 2 – Savonese (ASL2) (Itali), Instituti për Politikë dhe Punë Sociale – Instituti Kombëtar për Parandalimin e Drogës (SZMI-NDI) (Hungari), Agjencia Kombëtare Anti-Drugë (NAA) (Rumani), dhe Byroja Kombëtare për Parandalimin e Drogës (NBDP) (Poloni). Lutemi shihni manualin për emrat e kontribuuesve individualë.

⁽³⁾ Standardet e fokusuar mbi 'çfarë' të bëhet në parandalim janë botuar nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC), shih *Standardet Ndërkombëtare mbi Parandalimin e Përdorimit të Drogës* tek <http://www.unodc.org/unodc/en/prevention/prevention-standards.html>


Në vijim të përfundimit të projektit, u përshtatën gjithashtu standardet e cilësisë evropiane në parandalimin e drogës mbi krijimin e një Kuadri EU për standardet minimale të cilësisë dhe etapat në reduktimin e nevojës për drogë (EQUUS) ⁽⁴⁾.

Mundësia e sigurimit të një kuadri për të cilin është rënë dakord, i cili të jetë i përshtatur për rrethanat e një vendi, duhet të ofrojë një stimul për Shtetet Anëtare të EU dhe vendet e tjera për të krijuar standardet e cilësisë aty ku ato nuk kanë ekzistuar më parë (ose të shqyrtojnë dhe përditësojnë standardet ekzistuese të cilësisë), dhe t'i përvetësojnë këto standarde cilësie për përdorim prej tyre. Përvetësimi i standardeve do të përmirësojë praktikën e parandalimit të drogës dhe efikasitetin dhe efektivitetin e vënies në përdorim, dhe reduktimin e gjasave të implementimit të ndërhyrjeve pa efekte ose me efekte jatrojgene (dmth negative). Kështu që, standardet do të mbështesin profesionistët e parandalimit në promovimin e krijimit të praktikave më të mira, dhe do t'i lejojë ata të demonstrojnë suksesin në arritjen e objektivave specifike të strategjive dhe politikave lokale, rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare të drogës.

Manuali që përmban të gjitha standardet është në dispozicion nga EMCDDA:
<http://www.emcdda.europa.eu/publications/manuals/prevention-standards>

Cikli i projektit – tre nivelet e detajeve

Figura 1: Cikli i projektit për parandalimin e drogës



Në një cikël projekti, standardet janë organizuar në mënyrë kronologjike. U pa se cikli i projektit përfaqëson mjetet më të mira të strukturimit të standardeve, bazuar mbi shqyrtimin e standardeve ekzistuese dhe konsultimet me profesionistët e parandalimit të drogës.

Cikli i projektit përmban tetë etapa: vlerësimi i nevojave; vlerësimi i burimeve; formulimi i programit; planifikimin e ndërhyrjes; menaxhimin dhe mobilizimin e burimeve; dorëzimin dhe monitorimin; vlerësimet përfundimtare; dhe propagandimi dhe përmirësimet. Në vijim, vlerësimet tërthore në qendër të ciklit të projektit nxjerrin në pah aspekte të cilat janë domethënëse për secilën etapë të

⁽⁴⁾ Projekti EQUUS u drejtua nga Instituti i Kërkimeve për Shëndetin Publik dhe varësinë në Universitetin e Zyrih dhe u bashkë-financua gjithashtu nga Bashkimi Evropian. Informacion i mëtejshëm mund të gjendet tek <http://www.isgf.ch/index.php?id=59&uid=41>

projektit, që do të thotë: mbështetshmëria dhe financimi; komunikimi dhe përfshirja e aksionerëve; zhvillimi i stafit; dhe etika e parandalimit të drogës (shih Figurën 1).

Cikli ofron një shabllon të cilin profesionistët mund ta *përvetësojnë* kur planifikojnë dhe implementojnë aktivitetet e parandalimit. Megjithatë, ky është gjithashtu edhe një model i thjeshtëzuar i punës për parandalimin e drogës, të cilin profesionistët duhet ta *përshtatin* me kujdes në rrethana të caktuara të punës së tyre parandaluese. Për shembull, nëse një aktivitet është tashmë në fazën e implementimit, atëherë etapat më të vonshme të projektit do të jenë më të rëndësishme se etapat e hershme të projektit në planifikimin e programit.

Secila etapë e projektit është e ndarë në disa përbërës të cilët planifikojnë cilat aksione do ndërmerren. Në total, janë 31 pjesë përbërëse përgjatë gjitha etapave të projektit dhe 4 përbërës me vlerësimet e tërthorta (shih Tabelën 1). Në manual, secila pjesë përbërëse përmban një tekst paraqitës i cili shpjegon se përse kjo pjesë përbërëse u përfshi tek standardet dhe çfarë elementesh duhen marrë parasysh gjatë implementimit. Rënditja e pjesëve përbërëse nuk tregon domosdoshmërisht prioritetin ose rendin kronologjik.

Tiparet përbëjnë nivelin e tretë brenda standardeve, duke përcaktuar secilën pjesë përbërëse në detaje më të mëdha. Në këtë nivel, bëhen të dallueshme standardet bazë dhe eksperte për t'u marrë parasysh për varietetin e punës parandaluese dhe kapacitetet e ndryshme të organizatave. Në këtë dokument janë përmbledhur vetëm standardet bazë, por të gjitha standardet mund të gjenden në manualin e plotë.

Tabela 1: Etapat e projektit dhe pjesët përbërëse në standardet evropiane të cilësisë në parandalimin e drogës

Vlerësimet e tërthorta
A: Mbështetja dhe financimi
B: Komunikimi dhe përfshirja e aksionerëve
C: Përpunimi i stafit
D: Parandalimi etik i drogës
1. Vlerësimi i nevojave
1.1 Njohja e politikës dhe legjislacionit që ka lidhje me drogën
1.2 Vlerësimi i përdorimit të drogës dhe nevojat e komunitetit
1.3 Përshkrimi i nevojës – Arsyeimi i ndërhyrjes
1.4 Të kuptuarit e popullatës në objektiv
2. Vlerësimi i burimeve
2.1 Vlerësimi i popullatës të objektiv dhe burimet e komunitetit
2.2 Vlerësimi i kapaciteteve të brendshme
3. Formulimi i programit
3.1 Përcaktimi i popullatës në objektiv
3.2 Përdorimi i një modeli teorik
3.3 Përcaktimi i tendencave, qëllimeve dhe objektivave
3.4 Përcaktimi i mjedisit
3.5 Referimi ndaj efektivitetit të provave
3.6 Përcaktimi i afatit kohor
4. Planifikimi i ndërhyrjes
4.1 Planifikimi për cilësinë dhe efektivitetin
4.2 Nëse përzgjidhet një ndërhyrje ekzistuese
4.3 Përshtatja e ndërhyrjes për popullatën në objektiv
4.4 Nëse planifikohen vlerësimet përfundimtare
5. Menaxhimi dhe mobilizimi i burimeve
5.1 Planifikimi i programit – Ilustrimi i planit të projektit
5.2 Planifikimi i kërkesave financiare
5.3 Ngritja e ekipit
5.4 Rekrutimi dhe ruajtja e pjesëmarrësve
5.5 Përgatitja e materialeve të programit
5.6 Ofrimi i përshkrimit të programit
6. Dorëzimi dhe monitorimi
6.1 Nëse kryhet një ndërhyrje pilot
6.2 Implementimi i ndërhyrjes
6.3 Monitorimi i implementimit
6.4 Përshtatja e implementimit
7. Vlerësimet përfundimtare
7.1 Nëse kryhet një vlerësim i rezultatit
7.2 Nëse kryhet një vlerësim i procesit
8. Propagandimi dhe përmirësimet
8.1 Përcaktimi nëse programi duhet mbështetur
8.2 Shpërndarja e informacionit në lidhje me programin
8.3 Nëse krijohet një raport përfundimtar

Përdorimi i manualit të standardeve të cilësisë

Ky udhëzues i shpejtë është një përmbledhje e standardeve të cilësisë tek i cili mund të arrihet nëpërmjet faqes së internetit të vënë në dukje në kutinë në faqen 5. Në manual, standardet e cilësisë janë kuptuar si etapa të cilat ndihmojnë profesionistët e parandalimit për të gjykuar nëse një aktivitet, një mbështetës, etj., përfaqësojnë cilësinë e lartë. Manuali i standardeve inkurajon ushtruesit e profesionit dhe profesionistët e tjerë të cilët punojnë në fushën e parandalimit për të menduar rreth

asaj sesi aktivitetet ekzistuese kanë lidhje me standardet dhe si mund të përmirësohen duke përdorur standardet në mënyrë që të përftohen rezultate (edhe më) të mira dhe më mbështetëse.

Manuali ofron udhëzues të detajuar mbi atë se si duhet dhe si nuk duhet të përdoren standardet. Shkurtimisht, profesionistët do të përfitojnë më së shumti nga manuali i standardeve nëse ata e përdorin:

- për informim dhe udhëzim (p.sh. kurset e universitetit, supervizimi)
- për vetë-reflektim ose diskutim në njësi grupesh (p.sh. nga profesionistët të cilët janë në kontakt (direkt) me popullatën në objektiv, nga menaxherët e shërbimeve ose skuadrat rajonale të planifikimit)
- si listë-kontrolli gjatë krijimit ose vlerësimit (p.sh. për krijuesit e programeve, vlerësuesit)
- për krijimin ose përditësimin e kriterëve të cilësisë (p.sh. politikë-bërësit, financuesit)
- për vlerësimin e performancës (p.sh. për të identifikuar nevojat e zhvillimit profesional).

Standardet janë caktuar për një gamë të gjerë të aktiviteteve të parandalimit të drogës (p.sh. edukimi për drogën, programet e strukturuar, punët e shpërndara, ndërhyrjet e përmbledhura), njësitë (p.sh. shkolla, komuniteti, familja, njësitë e argëtimit, sistemi i drejtësisë) dhe popullatat në objektiv (të rinjtë, familjet, grupet etnike). Aktivitetet e parandalimit të drogës që vihen në objektiv nga këto standarde mund të fokusohen mbi substancat legale, të tilla si alkooli ose duhani, dhe/ose substancat ilegale.

Duke pranuar diversitetin brenda punës parandaluese, standardet e plotë ofrojnë dy nivele të ndryshme: atë 'bazë' dhe atë 'ekspert'. Standardet bazë duhet të zbatohen në të gjitha veprimtaritë e parandalimit të drogës, pavarësisht rrethanave të veçanta. Standardet eksperte paraqesin një nivel më të lartë të cilësisë; sidoqoftë, ato mund të mos jetë të zbatueshme gjithmonë dhe përdoruesit e standardeve do të duhet të vendosin nëse ato janë të rëndësishme, të dobishme dhe fizibile në lidhje me një aktivitet të caktuar të parandalimit. Për thjeshtësi, ky udhëzues i shpejtë i referohet vetëm standardeve bazë.

Megjithëse fokusimi i standardeve është tek parandalimi, ato mundet, që gjithashtu, të ndihmojnë profesionistët që të vlerësojnë sesi njerëzit, organizatat, politikat dhe strategjitë (qeveritare) kontribuojnë në parandalimin e drogës. Në fakt, disa standarde mund të arrihen vetëm duke marrë parasysh dhe përmirësuar kontekstin praktik dhe strategjik në të cilin janë mbështetur intervenimet. Për shembull, prioritetet dhe strategjitë e përcaktuara nga trupat qeveritare dhe financuese duhet të promovojnë praktikën e mirë në parandalim.

Bazuar në konsultimet e ndërmarra për të krijuar standardet, manuali është më pak i përshtatshëm për pikësynime të caktuara. Përdorimi i cilësisë së standardeve nuk mund të zëvendësojë procesin dhe rezultatet e vlerësimeve. Megjithëse standardet mund të ndihmojnë në arritjen e rezultateve më të mira të vlerësimit, vlerësimet vazhdojnë të jenë të nevojshme për të kuptuar nëse dhe si funksionojnë intervenimet. Ashtu siç parashtrohet në manual, standardet janë gjithashtu më pak të përshtatshme për vetë-vlerësimin formal, trajnimin e strukturuar, akreditimin e jashtëm ose vendimet e financimit. Por, do të zhvillohet një projekt vazhdimësie, i titulluar 'Promovimi i Ekselencës në Parandalimin e Drogës në EU – Faza 2 e Projektit të Standardeve Evropiane të Cilësisë në Parandalimin e Drogës' nga prilli i 2013 deri në mars 2015, për t'i bërë standardet më të përshtatshme për këto qëllime të veçanta. Ai do të shqyrtojë gjithashtu, sesi mundet që standardet të mund të përmirësojnë aktivitetet parandaluese në 'botën e vërtetë' dhe si mund të evidentohen formalisht arritjet e standardeve. Si pjesë e këtij projekti vazhdimësie, do të publikohen shembuj se si po përdoren standardet në Evropë dhe jashtë saj, si dhe mjetet për të mbështetur implementimin e standardeve në faqen e internetit www.prevention-standards.eu.

Përdorimi i këtij udhëzuesi të shpejtë dhe listës së kontrollit

Ky udhëzues i shpejtë është planifikuar për:

- profesionistët të cilët nuk janë familiarizuar ende me konceptin e standardeve të cilësisë në parandalim dhe për ata që dëshirojnë të dinë më shumë për këtë çështje
- profesionistët të cilët kanë nevojë për më shumë informacion në lidhje me standardet në mënyrë që të vendosin nëse manuali mund të mbështesë dobishëm punën e tyre

- profesionistët të cilët dëshirojnë të hedhin hapin e parë në kryerjen e vetë-reflektimit duke përdorur standardet.

Ky material do të jetë me veçanërisht i dobishëm në terma të grupeve profesionale, politikë-bërëse dhe komisionerëve në nivele kombëtare, rajonale dhe lokale, ashtu si edhe menaxhuesit e shërbimeve.

Megjithëse tashmë manuali është përkthyer në shumë gjuhë (shih faqen e internetit të EMCDDA për detaje), ky dokument ka gjithashtu për qilim që të lehtësojë paraqitjen e standardeve në vendet ku nuk është ende në dispozicion përkthimi i manualit të plotë.

Ky dokument nuk zëvendëson manualin ekzistues. Në fakt, ky udhëzues i shpejtë përmbledh përmbajtjen e manualit dhe inkurajon profesionistët të fillojnë të përdorin standardet për vetë-reflektim. Midis manualit dhe këtij udhëzuesi të shpejtë ekzistojnë shumë ndryshime të rëndësishme. Më e rëndësishmja, manuali rendit standardet aktuale, duke bërë dallimin ndërmjet midis nivelit të standardeve bazë dhe atyre eksperte. Ky dokument nuk përmban standardet aktuale – ai ofron vetëm një përmbledhje të standardeve bazë. Për më tepër, në manual përfshihen një paraqitje e detajuar, informacion i detajuar se si të përdoren standardet, një fjalor gjithëpërfshirës, si dhe një listë e dokumenteve origjinale mbi të cilat janë bazuar standardet. Ky informacion është i nevojshëm për kuptimin e mirë të përmbajtjes dhe domethënies së standardeve.

Ku është e mundur, përdoruesit e udhëzuesit të shpejtë duhet duket të konsultohen me manualin e plotë për përfitim të kuptimit më të mirë të standardeve. Materialet shtesë janë gjithashtu në dispozicion në mënyrë elektronike në faqen e EMCDDA dhe në faqen e projektit (shih link-et në kutinë në faqen 5).

Për shkak të detajeve të kufizuara të ofruara në këtë dokument dhe fokusimit të tij mbi informacionin e përgjithshëm dhe vetë-reflektimin fillestar, udhëzuesi i shpejtë është pak i përshtatshëm për qëllime të tjera (p.sh. krijimin e kriterëve të cilësisë). Profesionistët e interesuar në përdorimin e standardeve për qëllime të tilla, duhet t'i referohen vetëm manualit të plotë.

Në pjesën tjetër të këtij udhëzuesi, janë paraqitur shkurtimisht të gjitha etapat e projektit dhe pjesët përbërëse të standardeve, duke vënë theksin se pse janë të rëndësishme dhe të dobishme për profesionistët e parandalimit dhe popullatat në objektiv. Standardet bazë janë përmbledhur në formën e listës kontrolluese për vetë-reflektim, e cila, gjithashtu, i pajis përdoruesit me një hapësirë të dedikuar për të reflektuar mbi punën e tyre në lidhje me secilën pjesë përbërëse. Tabelat në kontroll-listë konsistojnë në pesë kolona: përmbledhja e standardeve bazë; tre kuti kontrolli për të përcaktuar shtrirjen në të cilën janë përmbushur aktualisht standardet; një kuti kontrolli 'E paaplikueshme'; një hapësirë për shënime mbi pozitën aktuale; dhe një hapësirë për regjistrimin e veprimeve të nevojshme të ndjekjes së veprimeve. Në përfundim të udhëzuesit të shpejtë, një faqe përmbledhëse i inkurajon lexuesit të mbajnë shënim gjetjet kryesore dhe veprimet që dalin në dukje nga plotësimi i listë-kontrollit.

Tabela "Si të plotësohet listë-kontrolli" tregon pjesët e kontroll-listës dhe si mund të plotësohen ato.

Qëllimi i kontroll-listës është të lehtësojë vetë-reflektimin fillestar, dmth të përcaktojë pozitën përkatëse të dikujt në lidhje me standardet dhe të identifikojë fushat për përmirësim. Natyra e saktë e kësaj detyre do të jetë në varësi të rrethanave të veçanta të programit ose organizimit ('Çfarë dëshirohet të arrihet prej meje/nesh?') dhe çfarë është realiste ('Çfarë mund të arrij unë/ne aktualisht?'). Në manual, disa standarde përmbajnë shembuj sesi arritjet mund të evidentohen në praktikë; kjo mund të ndihmojë profesionistët të gjykojnë nëse janë përmbushur standardet. Programi i vazhdimësisë që do të implementohet nga prill 2013 deri në mars 2015 do të ofrojë gjithashtu tregues specifikë për të evidentuar arritjen e standardeve. Burimet e evidencave mund të përfshijnë evidenca të shkruara, për shembull planin e projektit ose përkthimin e organizimit (p.sh. në faqen në web të kompanisë/shërbimit), shqyrtimi direkt i procedurave të punës ose programit të implementimit, apo diskutimet me anëtarët e stafit, pjesëmarrësit dhe/ose aksionerët e tjerë. Sidoqoftë, kontroll-lista nuk kërkon që përdoruesit e këtij dokumenti të evidentojnë formalisht arritjen e standardeve. Profesionistët e interesuar në kryerjen e vetë-vlerësimit formal duke përdorur standardet do të përfitojnë nga mjetet që po zhvillohen si pjesë e vijimësisë së projektit (www.prevention-standards.eu).

Si të plotësohet kontroll-lista

Standardet bazë (përmbledhje):	Të papërbushur a	Pjesërisht të përbushura	Plotësisht të përbushura	E paaplikueshme	Shënime mbi pozitën aktuale	Veprimet për t'u ndërmarrë
Kjo pjesë përmban titujt e pjesëve përbërëse dhe <i>përmbledh</i> standardet bazë të përfshira brenda çdo komponenti. Ndërkohë që marrin parasysh çdo komponent, përdoruesit duhet të konsultojnë versionin e plotë të standardeve për të mësuar në lidhje me standardet bazë dhe eksperte në detaje. Kjo ka për t'i ndihmuar për të reflektuar dhe për të përcaktuar pozicionin e tyre.	Kjo pjesë e listës së kontrollit ju bëjnë të mundur përdoruesve të klasifikojnë punën e tyre (p.sh. profesionistët e zhvillimit, aktivitetit, organizimit, strategjisë, etj.) në lidhje me standardet duke vënë shenjën në kategorinë 'E papërbushur', 'Pjesërisht e përbushur', ose 'E përbushur'. Pozicionimi i punës së tyre përgjatë kësaj shkalle, do të ndihmojë profesionistët të identifikojnë fushat për përmirësime dhe të ndjekin progresin me kalimin e kohës. Duke folur përgjithësisht, kategoria 'E papërbushur' duhet të zgjidhet nëse asnjë ose shumë pak standarde janë përbushur, 'Pjesërisht e përbushur' duhet të përzgjidhet nëse të gjitha ose standardet bazë janë përbushur, dhe kategoria 'Plotësisht e përbushur' duhet të përzgjidhet nëse të gjitha standardet bazë dhe të gjitha ose pjesa më e madhe e standardeve eksperte janë përbushur, megjithëse kjo do të jetë në varësi të rrethanave të veçanta të programit ose organizimit.	Mundësia 'E paaplikueshme' duhet të shënohet vetëm nëse kërkohet dhe pas një vlerësimi të thellë të rëndësisë së standardit. Përdoruesit duhet të jenë të vetëdijshëm për përzgjedhjen mjaft lirshëm të kësaj mundësie, duke pranuar në fakt se ndoshta standardi është i zbatueshëm, por aktualisht nuk është i zbatueshëm. Nëse zgjidhet mundësia 'E paaplikueshme' duhet të ofrohet një koment i shkurtër në kolonën 'Shënime mbi pozicionin aktual', duke sqaruar se përse koment i konsiderua (aktualisht) i aplikueshëm.	Kjo kolonë ju lejon përdoruesve të komentojnë mbi klasifikimin e tyre. Kjo jep një mundësi për të përshkruar se cilat standarde janë arritur tashmë dhe të ofrojë evidenca për të mbështetur klasifikimin (duke iu referuar pjesëve të prekshme të evidencave, aty ku është e mundur). Kjo është një mundësi për të bërë të qartë punën e mirë që është duke u bërë. Gjithashtu, përdoruesit duhet ta përdorin këtë hapësirë për të vënë në dukje dobësitë dhe fushat që akne nevojë për përmirësim (p.sh. cilat standarde nuk janë përbushur ende dhe përse).	Në këtë kolonë duhet të konturohen veprimet dhe ndryshimet e nevojshme për të përmirësuar përpjekjet aktuale. Kjo mund të përfshijë, për shembull, nevojën për të riparuar planin e projektit ose nevoja për trajnim të stafit shtesë. Veprimet dhe ndryshimet duhet të jenë realiste në mënyrë që ta bëjnë reflektimin praktikisht të rëndësishëm: 'Çfarë veprimesh dhe ndryshimesh mund të bëj unë/ne tani (ose në të ardhmen e parashikueshme) për të përmirësuar përpjekjet e mia/tona në parandalimin e drogës?' Sidoqoftë, kjo mund të jetë gjithashtu e dobishme për të vërejtur aksionet afat-gjata dhe qëllimet të cilat mund të arrihen në një kohë më të vonë (p.sh. ndjekjen e rishikimit të ardhshëm). Në mënyrë që aksionet të bëhen më specifike, mund të jetë ndihmuese të mendohet dhe të mbahen shënime: <i>kur</i> do të ndodhin këto ndryshime; <i>kush</i> ka për t'u përfshirë; dhe çfarë <i>burimesh</i> do të nevojiten.		

Lutemi t'i referoheni listës së plotë të standardeve bazë dhe eksperte në manualin EMCDDA kur kryeni vetë-reflektimin tuaj, shihni:

<http://www.emcdda.europa.eu/publications/manuals/prevention-standards>

Standardet dhe lista e kontrollit

Vlerësimet e tërthorta

Shumë tema që përsëriten, nuk kanë të bëjnë vetëm me një fazë të projektit, por me të gjithë ciklin e projektit. Për arsye të këtyre standardeve, katër prej këtyre temave janë vendosur në mes të ciklit të projektit ashtu siç duhet të ridiskutohen në secilën etapë të projektit.

A: Mbështetja dhe financimi

Programet duhet të shihen si të përfshira në një kuadër më të gjerë të veprimtarive të parandalimit të drogës. Realizueshmëria afat-gjatë e punës parandaluese duhet të sigurohet për sa më gjatë të jetë e mundur. Në mënyrë ideale, programet mund të vazhdojnë përtej implementimit të tyre fillestar dhe/ose pasi të jetë ndërprerë financimi i jashtëm i tyre. Sidoqoftë, mbështetshmëria është jo vetëm në varësi jo vetëm të mundësisë së vazhdueshme të financimit, por dhe të zgjatjes së kohës së përkushtimit të stafit dhe të aksionerëve të tjerë të rëndësishëm në këtë organizim dhe/ose fushën e parandalimit të drogës. Standardet në këtë komponent përcaktojnë se si mund të sigurohet mbështetja nga programet 'ankoruese' brenda sistemeve ekzistuese dhe nga zhvillimi i strategjive për të siguruar durimet e nevojshme, veçanërisht financimin.

B: Përfshirja e komunikimit dhe aksionerëve

Aksionerët janë individë, grupe dhe organizata të cilët kanë një interes që mbulon aktivitetet dhe rezultatet e programit, dhe/ose që janë të prekur direkt ose indirekt nga ai, siç është popullata në objektiv, komuniteti, financuesit dhe organizata të tjera të cilët punojnë në fushën e parandalimit të drogës. Aksionerët e rëndësishëm duhet të kontaktohen dhe të përfshihen në program si të jetë e nevojshme. Për çdo program do të kërkohej mbështetja dhe bashkëpunimi i popullatës në objektiv. Forma të tjera të përfshirjes së aksionerëve mund të përmbledhin krijimin e lidhjeve me 'drejtuesit' e komunitetit ose median lokale e cila për rrjedhojë mbështet programin dhe rrit shikueshmërinë e saj. Përfshirja e organizatave të tjera që punojnë në këtë fushë është e dobishme për koordinimin e përpjekjeve, shkëmbimin e eksperiencave të fituara, dhe krijimin e bashkimit të planifikimit dhe buxhetit. Një strategji komunikimi bën të mundur shkëmbimin ndërmjet grupeve të përfshira në program.

C: Krijimi i stafit

Ky komponent konsiston në tre shtylla: trajnimi i stafit; zhvillime të mëtejshme; dhe mbështetja profesionale dhe emocionale. Nevojat për trajnimin e stafit duhet të vlerësohen përpara implementimit, dhe anëtarët e stafit duhet të trajnohen për të siguruar se programi paraqitet në një standard të lartë. Megjithatë kompetencat profesionale, si të tilla, nuk janë në fokus të standardeve, standardet mund të lehtësojnë krijimin e planeve trajnuese duke përvijuar llojet e kompetencave profesionale që duhet të kenë anëtarët e stafit⁽⁵⁾. Zhvillimi i mëtejshëm i stafit është një mënyrë e vlerësimit dhe ritrajnimit të anëtarëve të stafit dhe duke u siguruar se njohuritë dhe aftësitë e tyre janë të përditësuara. Gjatë implementimit të programit, është e rëndësishme që anëtarëve të stafit t'ju jepet mundësia për reflektim mbi punën e tyre dhe në përmirësimin e saj.

D: Parandalimi etik i drogës

Aktivitetet e parandalimit të drogës mund të mos kenë nevojë për ndërhyrje fizike ose klinike, por megjithatë, këto përfaqësojnë një formë të ndërhyrjes në jetët e njerëzve. Për më tepër, parandalimi zakonisht, vë në shënjestër të rinjtë, dhe në rastin e parandalimit të përzgjedhur duke ndikuar pasi këta të rinj mund të jenë ndër më të prekshmit në shoqëri. Profesionalistët nuk duhet të supozojnë se aktivitetet për parandalimin e drogës janë për përcaktim etik dhe përfitues për pjesëmarrësit. Standardet krijojnë parimet e parandalimit etik të drogës të cilat fokusohen në: sjelljen ligjore të ofruesit; respekti për të drejtat dhe autonominë e pjesëmarrësve; mos-dëmtimi i pjesëmarrësve; dhënia e informacionit të vërtetë; marrja e aprovimit; pjesëmarrja vullnetare; sigurimi i konfidencialitetit; përshtatja e ndërhyrjes sipas nevojave të pjesëmarrësve; përfshirja e pjesëmarrësve si partnerë; dhe shëndeti e siguria. Ndërkohë që jo gjithnjë mund të jetë e mundur përmbajtja ndaj të gjitha parimeve të parandalimit etik të drogës, në çdo etapë të projektit duhet të jetë qartësisht evident trajtimi etik. Rrjedhimisht, protokollet janë ndërtuar për të mbrojtur të drejtat pjesëmarrësve, dhe janë vlerësuar dhe zvogëluar rreziqet potenciale.

⁽⁵⁾ Për një shembull burimi që i dedikohet kësaj çështjeje shihni 'Kompetencat për Forcën e Abuzimit me Substancat të Kanadasë' krijuar nga Qendra Kanadeze për Abuzimin me Substancat (CCSA), në dispozicion tek www.ccsa.ca/eng/priorities/workforce/competencies/

Vlerësimet e tërthorta

Standardet bazë (përmbledhje):	Të papërbushura	Pjesërisht të përbushura	Plotësisht të përbushura	E paaplikueshme	Shënime mbi pozitën aktuale	Veprimet për t'u ndërmarë
A: Mbështetja dhe financimi: Programi promovon një shikim afat-gjatë mbi parandalimin e drogës dhe nuk fragmentohen në iniciativa afat-shkurta. Programi është koherent në trajtimin e tij logjik dhe praktik. Programi kërkon financime nga burime të ndryshme.	☐	☐	☐	☐		
B: Përfshirja e komunikimit dhe aksionerëve: Është konsideruar natyra e shumë shërbimeve e parandalimit të drogës. Të gjithë aksionerët e rëndësishëm për programin (p.sh. popullata në objektiv, agjencitë e tjera) identifikohen dhe përfshihen sipas nevojës për një implementim të suksesshëm të programit. Organizata bashkëpunon me agjenci dhe institucione të tjera.	☐	☐	☐	☐		

Vlerësimet e tërthorta (vijon)

Standardet bazë (përmbledhje):	Të papërbushura				Shënime mbi pozitën aktuale	Veprimet për t'u ndërmarë
	Pjesërisht të përbushura	Plotësisht të përbushura	E paaplikueshme			
C: Krijimi i stafit: Përpara implementimit sigurohet që anëtarët e stafit të kenë kompetencat të cilat janë të nevojshme për një implementim të suksesshëm të programit. Nëse është e nevojshme, ofrohet trajnim i cilësisë së lartë bazuar mbi analizat e nevojave të trajnimit. Gjatë implementimit, anëtarët e stafit mbështeten në punën e tyre si të jetë e përshtatshme.	☐	☐	☐	☐		
D: Parandalimi etik i drogës: Përcaktohet një kod etike. Mbrohen të drejtat e pjesëmarrësve. Programi ka përfitime të qarta për pjesëmarrësit, dhe nuk ka për t'ju shkaktuar atyre asnjë dëm. Të dhënat e pjesëmarrësve trajtohen në koefidencë. Mbrohet siguria fizike e pjesëmarrësve dhe anëtarëve të stafit.	☐	☐	☐	☐		

Lutemi t'i referoheni listës së plotë të standardeve bazë dhe eksperte në manualin EMCDDA kur kryeni vetë-reflektimin tuaj, shihni: <http://www.emcdda.europa.eu/publications/manuals/prevention-standards>

Etapa e projektit 1: Vlerësimi i nevojave

Përpara se ndërhyrja të planifikohet në detaje, është e rëndësishme që të eksplorohet natyra e nevojave që kanë lidhje me drogën, si dhe shkaqet e mundshme dhe faktorët kontribuues për këto nevoja. Kjo siguron se ndërhyrja është e rëndësishme dhe kjo do të trajtojë me korrektësi nevojat dhe popullatën (popullatat) në objektiv. Janë vënë në dukje katër lloje të nevojave: nevojat e politikës; nevojat (e përgjithshme) të popullatës; nevojat e përcaktuara nga boshllëqet në ofrimin e parandalimit; dhe nevojat (specifike) të popullatës në objektiv.

1.1 Njohja e politikës dhe legjislacionit që ka lidhje me drogën: Politika dhe legjislacioni që ka lidhje me drogën duhet të udhëheqë të gjitha aktivitetet parandaluese. Skuadra duhet të jetë në dijeni dhe të punojë në përputhje me politikën dhe legjislacionin që ka lidhje me drogën në nivel lokal, rajonal, dhe/ose ndërkombëtar. Aty ku programet trajtojnë nevoja të cilat aktualisht nuk janë prioritet i politikës aktuale, programet ende duhet të mbështesin një axhendë më të gjerë të parandalimit të drogës ashtu siç përcaktohet nga strategjitë kombëtare ose ndërkombëtare. Udhëzuesit e tjerë, të tilla si strategjitë dhe udhëzuesit detyrues, duhet që gjithashtu të merren parasysh kur është e përshtatshme.

1.2 Vlerësimi i përdorimit të drogës dhe nevojat e komunitetit: Komponenti i dytë në këtë etapë të projektit specifikon kërkesën për të vlerësuar situatën e drogës në popullatën e përgjithshme ose në nën-popullatën specifike. Kur planifikohet puna parandaluese, nuk është e mjaftueshme për t'u mbështetur mbi supozime ose ideologji. Në fakt, programet e parandalimit të drogës duhet të informohen nga një vlerësim empirik i nevojave të njerëzve. Vlerësimi mund të përdorë metoda sasiore dhe/ose cilësore dhe duhet të hartohet mbi të dhënat ekzistuese (epidemiologjike) kur janë tashmë në dispozicion të dhënat e rëndësishme cilësore (p.sh. nga vërtetimet kombëtare për drogën). Çështje të tilla të rëndësishme, të tilla si privimi dhe pabarazia, duhet të vlerësohen gjithashtu, që të llogariten për marrëdhënien ndërmjet përdorimit të drogës dhe nevojave të tjera. Kur njëri ka nevojë për vlerësim, mund të informojë aktivitete të tjera të ndryshme përgjatë një hapësire të caktuar kohore, megjithëse është e rëndësishme të sigurohet se të dhënat janë të përditësuara. Skuadrat rajonale të koordinimit për drogën mund të kenë një rol të rëndësishëm për të luajtur në arritjen e këtyre standardeve.

1.3 Përshkrimi i nevojës – Arsyetimi i ndërhyrjes: Gjetjet nga vlerësimi i nevojave të komunitetit janë dokumentuar dhe janë vendosur sipas kontekstit për të arsyetuar nevojën për ndërhyrje. Arsyetimi duhet të marrë parasysh pikëpamjet e komunitetit për të siguruar se programi është i rëndësishëm për ta. Fokusimi për 'nevojën' në vend të 'problemit' mund të ndihmojë në përfshirjen e aksionerëve të cilët në të kundërt ndihen të stigmatizuar. Në këtë pikë janë analizuar gjithashtu edhe programet ekzistuese të parandalimit të drogës për të plotësuar arsyetimin se si programi mund të plotësojë strukturën aktuale të përgatitjeve.

1.4 Të kuptuarit e popullatës në objektiv: Vlerësimi i nevojave më pas shtyhet më tej duke mbledhur të dhëna të detajuara mbi popullatën e mundshme në objektiv, siç është informacioni në lidhje me riskun dhe faktorët mbrojtës, dhe kultura e popullatës në objektiv dhe jeta e përditshme. E kuptuara e mirë e popullatës në objektiv dhe realitetet e saj janë një kusht paraprak për një parandalim efikas, efektiv në kosto dhe etik të drogës. Aty ku është e përshtatshme, popullata e ndërmjetme në objektiv, e cila do të përftojë ndërhyrjen, por nuk është në vetvete në risk për përdorim droge (p.sh. prindërit, mësuesit) mund të kenë nevojë të merret në konsideratë, në vijimësi të popullatës kryesore në objektiv (p.sh. të rinjtë me risk për përdorimin e drogës).

Kjo etapë mund të kryhet në të njëjtën kohë, ose pas, vlerësimit të burimeve.

1. Vlerësimi i nevojave

Standardet bazë (përmbledhje):	Të papërbushura Pjesërisht të përbushura Plotësisht të përbushura E paaplikueshme	Shënime mbi pozitën aktuale	Veprimet për t'u ndërmarë
1.1 Njohja e politikës dhe legjislacionit që ka lidhje me drogën: Njohja e politikës dhe legjislacionit që ka lidhje me drogën është e mjaftueshme për implementimin e programit. Programi mbështet objektivat e prioriteteve, politikave dhe strategjive lokale, rajonale, kombëtare dhe/ose ndërkombëtare.	☐ ☐ ☐ ☐		
1.2 Vlerësimi i përdorimit të drogës dhe nevojat e komunitetit: Janë vlerësuar nevojat e komunitetit (ose mjedisit në të cilin do të zbatohet programi). Është mbledhur informacion i detajuar dhe i ndryshëm mbi përdorimin e drogës. Studimi vë në përdorim njohuritë ekzistuese epidemiologjike sipas mundësisë dhe i përmbahet parimeve të kërimit etik.	☐ ☐ ☐ ☐		

Lutemi t'i referoheni listës së plotë të standardeve bazë dhe eksperte në manualin EMCDDA kur kryeni vetë-reflektimin tuaj, shihni: <http://www.emcdda.europa.eu/publications/manuals/prevention-standards>

1. Vlerësimi i nevojave (vijon)

Standardet bazë (përmbledhje):	Të papërbushura	Pjesërisht të përbushura	Plotësisht të përbushura	E paaplikueshme	Shënime mbi pozitën aktuale	Veprimet për t'u ndërmarë
1.3 Përshkrimi i nevojës – Arsjetimi i ndërhyrjes: Nevoja për ndërhyrje është e arsyetuar. Vihet në dukje se nevojat kryesore janë përshkruar në bazë të vlerësimit të nevojave dhe zhvillimeve të ardhshme potenciale të situatës pa një intervenim. Janë identifikuar boshllëqet në ofrimin aktual të shërbimit.	☐	☐	☐	☐		
1.4 Të kuptuarit e popullatës në objektiv: Është përzgjedhur një popullatë potenciale në objektiv në përputhje me vlerësimin e nevojave. Vlerësimi i nevojave merr parasysh kulturën e popullatës në objektiv dhe perspektivën e saj në përdorimin e drogës.	☐	☐	☐	☐		

Lutemi t'i referoheni listës së plotë të standardeve bazë dhe eksperte në manualin EMCDDA kur kryeni vetë-reflektimin tuaj, shihni:
<http://www.emcdda.europa.eu/publications/manuals/prevention-standards>

Etapa e projektit 2: Vlerësimi i burimeve

Programi nuk përcaktohet vetëm nga nevojat e popullatës në objektiv, por edhe nga burimet në dispozicion. Ndërkohë që vlerësimi i nevojave (shih 1: Vlerësimi i Nevojave) vë në dukje se çfarë ka për qëllim të arrijë programi, vlerësimi i burimeve ofron informacion të rëndësishëm në lidhje me nëse dhe si mund të arrihen këto qëllime. Rrjedhimisht burimet duhet të vlerësohen për të përfutur një kuptim realist të llojit të dëshirueshëm dhe shtrirjes së mundshme të programit.

2.1 Vlerësimi i popullatës të objektiv dhe burimet e komunitetit: Programet e parandalimit të drogës mund të jenë të suksesshme vetëm nëse popullata në objektiv, komuniteti dhe aksionerët e rëndësishëm janë 'të gatshëm' të përfshihen, p.sh. kanë mundësinë dhe vullnetin të marrin pjesë ose të mbështesin implementimin. Gjithashtu, ata mund të kenë burime të cilat mund të vihen në përdorim si pjesë e programit (p.sh. rrjetet, aftësitë). Standardet në këtë komponent përfshijnë kërkesat për të vlerësuar dhe marrë parasysh burimet potenciale për kundërshtimin dhe mbështetjen për programin, ashtu si edhe burimet në dispozicion të aksionerëve të rëndësishëm.

2.2 Vlerësimi i kapaciteteve të brendshme: Analiza e burimeve dhe kapaciteteve të brendshme është e rëndësishme, pasi programi do të bëhet i zbatueshëm vetëm nëse është në një linjë me stafin, financat dhe burimet e tjera në dispozicion. Kjo etapë zbatohet përpara formulimit të programit për të përfutur një kuptueshmëri se cilat lloje programesh mund të jenë të zbatueshme. Duke qenë se qëllimi i vlerësimit është të informojë planifikimin e programit, ky nuk ka nevojë që të jetë një vlerësim 'formal' i kryer nga një organizatë e jashtme, por mundet, që për shembull, të konsistojë në një diskutim informal midis anëtarëve të stafit për të identifikuar pikat e forta dhe të dobëta organizative në lidhje me burime.

Kjo etapë mund të kryhet në të njëjtën kohë me vlerësimin e burimeve, ose në fillim të projektit, përpara vlerësimit të burimeve.

2 . Vlerësimi i burimeve

Standardet bazë (përmbledhje):	Të papërbushura				Shënime mbi pozitën aktuale	Veprimet për t'u ndërmarë
	Pjesërisht të përbushura	Plotësisht të përbushura	E paaplikueshme			
2.1 Vlerësimi i popullatës të objektiv dhe burimet e komunitetit: Merren parasysh burimet për të kundërshtuar dhe mbështetur programin, si dhe mënyrat e rritjes së nivelit të mbështetjes. Vlerësohet aftësia e popullatës në objektiv dhe aksionerëve të tjerë të rëndësishëm për të marrë pjesë në program.	☐	☐	☐	☐		
2.2 Vlerësimi i kapaciteteve të brendshme: Janë vlerësuar kapacitetet dhe burimet e brendshme (p.sh. burimet njerëzore, teknologjike, financiare). Vlerësimi merr parasysh aftësinë e tyre aktuale si edhe gjasat e disponimit të tyre të ardhshëm për programin.	☐	☐	☐	☐		

Lutemi t'i referoheni listës së plotë të standardeve bazë dhe eksperte në manualin EMCDDA kur kryeni vetë-reflektimin tuaj, shihni: <http://www.emcdda.europa.eu/publications/manuals/prevention-standards>

Etapa e projektit 3: Formulimi i programit

Formulimi i programit përvijon përmbajtjen dhe strukturën e programit, dhe ofron bazën e nevojshme për marrë parasysh planifikimin në objektiv, të detajuar, koherent dhe realist. Duhet të përcaktohen qartësisht elementet thelbësore të programit, bazuar mbi vlerësimin e nevojave të popullatës në objektiv dhe burimeve në dispozicion. Këto standarde kanë për qëllim të stimulojnë një ndryshim në kulturën profesionale ndaj një trajtimi më sistematik dhe të bazuar në evidenca në punën parandaluese të drogës.

3.1 Përcaktimi i popullatës në objektiv: Një përcaktim i mirë i popullatës në objektiv siguron që ndërhyrja vë në shënjestër njerëzit e duhur. Popullata në objektiv mund të konsistojë në individë, grupe, familje, komunitete, organizata, mjedise, dhe/ose njësi të tjera, për aq kohë sa janë të identifikueshëm dhe të përcaktuar qartë. Në disa programe mund të jetë e nevojshme të përcaktohet popullata fundore në objektiv (p.sh. të rinjtë me risk për përdorim droge). Përcaktimi duhet të jetë specifik dhe i përshtatshëm për qëllimin e programit. Për shembull, një vlerësim i rëndësishëm është nëse popullata në objektiv mund të arrihet brenda realiteteve të programit.

3.2 Përdorimi i një modeli teorik: Modeli teorik është një grup supozimesh që ndërlidhen duke shpjeguar si dhe përse një ndërhyrje ka gjasa të prodhojë rezultate në një popullatë në objektiv. Përdorimi i një modeli teorik i cili është i përshtatshëm për kontekstin e programit, shton mundësitë që programi të jetë i suksesshëm në arritjen e objektivave të tij. Ai ndihmon në identifikimin e mediatorëve të rëndësishëm të sjelljeve që kanë lidhje me drogën (të tilla si synimet dhe besimet të cilat ndikojnë përdorimin e drogës) dhe përcakton qëllime dhe objektiva të zbatueshme. Të gjitha ndërhyrjet duhet të bazohen në modele të shëndosha teorike, veçanërisht nëse janë krijuar të reja.

3.3 Përcaktimi i tendencave, qëllimeve dhe objektivave: Pa tendenca, qëllime dhe objektiva të qarta, ekziston një risk serioz që të kryhet punë parandaluese për drogën në favor të kësaj të fundit, dhe jo për përfitim të popullatës në objektiv. Standardet përdorin një strukturë tre-nivelesh të ndërlidhjes së tendencave, qëllimeve dhe objektivave. Tendencat përshkruajnë drejtimin afat-gjatë të programit, idenë e përgjithshme, synimin, ose qëllimin. Ato mund të jenë të arritshme ose jo brenda ndërhyrjes specifike, por ofrojnë një drejtim strategjik për aktivitetet. Qëllimet janë deklarata të qarta mbi rezultatet e programit për pjesëmarrësit (në termat e ndryshimit të sjelljes) në përfundim të ndërhyrjes. Objektivat përshkruajnë ndryshimet e menjëhershme ose të ndërmjetme të sjelljes tek pjesëmarrësit, gjë që është e nevojshme për të arritur qëllimin. Përfundimisht, objektivat operative përshkruajnë aktivitetet që janë të nevojshme për arritjen e qëllimeve dhe objektivave.

Faqja 120 e manualit në anglisht përmban një figurë e cila ilustron lidhjen ndërmjet qëllimeve, tendencave dhe objektivave, dhe ofron informacion të mëtejshëm mbi ndryshimet ndërmjet objektivave specifike (duke u fokusuar mbi ndryshimin e sjelljes) dhe objektivat operative (duke u fokusuar tek aktivitetet).

3.4 Përcaktimi i mjedisit: Mjedisi është një ambient social dhe/ose fizik, i tillë si familja, shkolla, vendi i punës, klubet e natës, komuniteti ose shoqëria, në të cilin zhvillohet intervenimi. Vlerësimi i nevojave mund të tregojë se janë të rëndësishme një ose më shumë mjedise; sidoqoftë, kur vendoset për mjedisin, duhet të merren parasysh konsiderata praktike (p.sh. lehtësia e hyrjes, bashkëpunimet e nevojshme). Një përcaktim i qartë i mjedisit është thelbësor, kështu që të tjerët mund të kuptojnë se ku dhe si është kryer ndërhyrja.

3.5 Referimi ndaj efektivitetit të provave: Kur planifikohet punë parandaluese për drogën, është e rëndësishme të qenit i informuar dhe të përdoret njohuria ekzistuese mbi 'çfarë funksionon' në parandalimin e drogës. Duhet të konsultohet baza ekzistuese e evidencave shkencore, dhe të theksohen gjetjet e rëndësishme për programin. Provat shkencore duhet të ndërthuren me eksperiencën profesionale të praktikuesve për të krijuar një intervenim, i cili të jetë i rëndësishëm në kontekstin e programit specifik. Kur nuk ka prova shkencore të efektivitetit, në vend të tyre, mund të përshkruhet eksperiencia e profesionistëve dhe ekspertiza e aksionerëve. Sidoqoftë, duhet të merret parasysh me kujdes kufizimi i këtyre formave të njohurive krahasuar me provat e kërkimeve të qëndrueshme (p.sh. përgjithësimi).

3.6 Përcaktimi i afatit kohor: Afati kohor realist është thelbësor në planifikimin dhe implementimin e programit, në mënyrë që stafi të caktojë objektivin dhe të koordinojë forcat. Ai paraqet planifikimin e programit të aktiviteteve dhe afatet kohore që zbatohen. Afati kohor mund të përditësohet gjatë implementimit të programit për të reflektuar zhvillimet e tij aktuale.

3. Formulimi i programit

Standardet bazë (përmbledhje):	Të papërbushura Pjesërisht të përbushura Plotësisht të përbushura E paaplikueshme	Shënime mbi pozitën aktuale	Veprimet për t'u ndërmarë
3.1 Përcaktimi i popullatës në objektiv: Është (janë) përshkruar popullata (popullatat) në objektiv të programit. Mund të arrihet tek popullata (popullatat) e përzgjedhur në objektiv.	☐ ☐ ☐ ☐		
3.2 Përdorimi i një modeli teorik: Programi është bazuar mbi një model teorik të bazuar në evidenca i cili mundëson një kuptim të nevojave specifike që kanë lidhje me drogën dhe vë në dukje sesi mund të ndryshohet sjellja e popullatës në objektiv.	☐ ☐ ☐ ☐		
3.3 Përcaktimi i tendencave, qëllimeve dhe objektivave: A është e qartë se çfarë po 'parandalohet' (cili lloj i përdorimit të drogës?) Tendencat, qëllimet dhe objektivat e programit janë të qarta, me lidhje logjike dhe me informacion nga nevojat e identifikuara. Janë etike dhe 'të dobishme' për popullatën në objektiv. Qëllimet dhe objektivat janë specifike dhe realiste.	☐ ☐ ☐ ☐		

Lutemi t'i referoheni listës së plotë të standardeve bazë dhe eksperte në manualin EMCDDA kur kryeni vetë-reflektimin tuaj, shihni:

<http://www.emcdda.europa.eu/publications/manuals/prevention-standards>

3. Formulimi i programit (vijon)

Standardet bazë (përmbledhje):	Shënime mbi pozitën aktuale				Veprimet për t'u ndërmarë
	Të papërbushura	Pjesërisht të përbushura	Plotësisht të përbushura	E paaplikueshme	
3.4 Përcaktimi i mjedisit: Është përshkruar mjedisi (mjediset) për aktivitetet. I përshtatet tendencave, qëllimeve dhe objektivave, burimeve në dispozicion dhe ka gjasa të prodhojë ndryshimin e dëshiruar. Janë identifikuar bashkëpunimet e nevojshme për implementimin e programit në këtë mjedis.	☐	☐	☐	☐	
3.5 Referimi ndaj efektivitetit të provave: Shqyrtimi i literaturës shkencore dhe/ose konsultimi i botimeve thelbësore mbi çështjet që kanë lidhje me programin. Informacioni i shqyrtuar është i cilësisë së lartë dhe i rëndësishëm për programin. Gjetjet kryesore janë përdorur për informimin e programit.	☐	☐	☐	☐	
3.6 Përcaktimi i afatit kohor: Afati kohor i programit është realist, dhe është ilustruar qartë dhe në mënyrë koherente. Afati kohor, kohë-zgjatja dhe shpeshtësia e aktiviteteve është e përshtatshme për programin.	☐	☐	☐	☐	

Lutemi t'i referoheni listës së plotë të standardeve bazë dhe eksperte në manualin EMCDDA kur kryeni vetë-reflektimin tuaj, shihni:
<http://www.emcdda.europa.eu/publications/manuals/prevention-standards>

Etapa e projektit 4: Planifikimi i ndërhyrjes

Përmbajtja e ndërhyrjeve zakonisht mbulohet tek udhëzuesit në vend të standardeve të cilësisë, pasi është specifik ndaj nevojave të popullatës në objektiv, qëllimeve të programit, etj. Megjithatë, ka disa aspekte formale të cilat mund të përgjithësohen. Këto standard asistojnë në krijimin e një ndërhyrjeje të re si dhe në përzgjedhjen dhe adaptimin e një ndërhyrjeje ekzistuese. Gjithashtu, standardet inkurajojnë marrjen parasysh të kërkesave për vlerësim si pjesë e planit të ndërhyrjes.

4.1 Planifikimi për cilësinë dhe efektivitetin: Pasi të jenë përcaktuar gurët e themelit, specifikohen detajet e tyre. Planifikimi i aktiviteteve të bazuar në evidenca, të cilat me gjasa kalohen si eksperiencë nga pjesëmarrësit, pasi përfshirja, interesimi dhe shprehja kuptimplotë është një aspekt i rëndësishëm në arritjen e grupit të qëllimeve dhe objektivave. Aty ku është e mundur, ndërhyrja krijohet si progresion logjik i aktiviteteve të cilat reflektojnë zhvillimin e pjesëmarrësve përgjatë gjithë ndërhyrjes. Konsultimi i një sërë burimesh mbi programet e implementuara më parë, mund të ndihmojë që të evitohet ndjekja e aktiviteteve të cilat tashmë kanë treguar se janë jo-efektive ose kanë ndikime jatrogjene.

Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC) kanë botuar *Standardet Ndërkombëtare në Parandalimin e Përdorimit të Drogës*. Standardet përshkruajnë ndërhyrjet dhe politikat që janë parë se krijojnë rezultate pozitive në rezultatet e parandalimit të drogës tek fëmijët, adoleshentët dhe adultët. Këto mund të gjenden tek: <http://www.unodc.org/unodc/en/prevention/prevention-standards.html>

4.2 Nëse përzgjidhet një ndërhyrje ekzistuese: Përpara krijimit të një intervenimi të ri, duhet të merret parasysh nëse mund të ekzistojë tashmë një intervenim i përshtatshëm, në formë praktike ose si manual. Në përzgjedhjen e një intervenimi ekzistues duhet të merren parasysh shumë faktorë, duke përfshirë nëse është i rëndësishëm për rrethanat e veçanta të programit dhe (në rastin e programeve të cilat nuk janë falas) nëse është i përballueshëm. Më pas, intervenimi përvetësohet për t'ju përshtatur situatës specifike të programit. Përvetësimi konsiston në ndryshime të kujdesshme, të qëllimshme dhe të planifikuara që i bëhen intervenimit kryesor përpara implementimit, për tu siguruar se është i përshtatshëm për rrethanat e veçanta të programit (p.sh. nevojat e popullatës në objektiv) dhe për të ruajtur ose shtuar efektivitetin e tij.

4.3 Përshtatja e ndërhyrjes për popullatën në objektiv: Pavarësisht nëse krijohet një ndërhyrje e re ose përshtatet një ndërhyrje ekzistuese, ndërhyrja duhet të përshtatet për popullatën në objektiv, në përputhje me gjetjet nga vlerësimi i nevojave. Në lidhje me këtë, një kompetencë thelbësore e stafit është ndjeshmëria kulturore, dmth vullneti dhe aftësia e anëtarëve të stafit për të kuptuar rëndësinë e (llojeve të ndryshme të) kulturës, të vlerësojnë diversitetin kulturor, të reagojnë me efektivitet ndaj nevojave të përcaktuara kulturore, dhe të përfshijnë konsideratat kulturore në të gjitha aspektet e punës së parandalimit të drogës. Nëse përdoret një ndërhyrje ekzistuese, përshtatja mund të kryhet si pjesë e procesit të përvetësimit. Në vijim, gjatë krijimit të e ndërhyrjes duhet të ndërtohet fleksibiliteti, duke ju lejuar praktikuesve të përshtatin ndërhyrjen gjatë implementimit pa pasur nevojë të devijojnë nga plani origjinal.

4.4 Nëse planifikohen vlerësimet përfundimtare: Në këtë fazë duhet të planifikohen monitorimi, procesi përfundimtar dhe vlerësimi i rezultateve. Vlerësimi i rezultateve është një mjet për të vlerësuar nëse qëllimet dhe objektivat u arritën, ndërsa procesi i vlerësimit është një mjet për të kuptuar se si u arritën këto, ose në disa raste, sesi nuk u arritën. Një skuadër vlerësuese duhet të vendosë mbi llojin e përshtatshëm të vlerësimit të programit, dhe të përcaktojë treguesit e vlerësimit në përputhje me qëllimet dhe objektivat. Duhet të sqarohet se cilat të dhëna do të mblidhen, dhe si do të mblidhen (p.sh. specifikat e afatit kohor dhe mjetet e mbledhjes së të dhënave). Aty ku planifikohet një vlerësim, duhet të përcaktohet forma e kërimit. Marrja parasysh e vlerësimit në këtë fazë, do të bëjë që ta kemi në dispozicion në formë të kënaqshme kur të na nevojitet.

Manuali ofron detaje të mëtejshme mbi procesin dhe vlerësimet e rezultateve, marrjen parasysh të mbledhjes së të dhënave dhe si të formulohen treguesit e vlerësimit dhe etapat duke u bazuar mbi qëllime dhe objektiva të specifikuar. Shih gjithashtu standardet në etapën e projektit 7: Vlerësimet përfundimtare.

Kjo etapë mund të kryhet në të njëjtën kohë me menaxhimin dhe mobilizimin e burimeve.

4. Planifikimi i ndërhyrjes

Standardet bazë (përmbledhje):	Të përmbyshura	Pjesërisht të përmbyshura	Plotësisht të përmbyshura	E paaplikueshme	Shënime mbi pozitën aktuale	Veprimet për t'u ndërmarë
4.1 Planifikimi për cilësinë dhe efektivitetin: Intervenimi ndjek rekomandimet e praktikës së mirë të bazuar mbi evidenca; përcaktohet trajtimi shkencor. Programi ndërtohet mbi marrëdhëniet pozitive me pjesëmarrësit duke njohur eksperiencat e tyre dhe duke respektuar diversitetin. Përfundimi i programit është i përcaktuar.	☐	☐	☐	☐		
4.2 Nëse përzgjidhet një ndërhyrje ekzistuese: Merren parasysh përparësitë dhe kufizimet e një intervenimi ekzistues, si dhe balanca ndërmjet përvetësimit, përpikmërisë dhe fizibilitetit. Vlerësohet përshtatja e intervenimit me rrethanat lokale. Intervenimi i përzgjedhur përvetësohet me kujdes dhe bëhen të qarta ndryshimet. Falënderohen autorët e intervenimit.	☐	☐	☐	☐		

4. Planifikimi i ndërhyrjes (vijon)

Standardet bazë (përmbledhje):	Të papërbushura Pjesërisht të përbushura Plotësisht të përbushura E paaplikueshme	Shënime mbi pozitën aktuale	Veprimet për t'u ndërmarra
4.3 Përshtatja e ndërhyrjes për popullatën në objektiv: Programi është i përshtatshëm për rrethana të caktuara të programit (p.sh. karakteristikat e popullatës në objektiv), dhe i përshtatur për të, nëse është e nevojshme. Elementet e përshtatjes përfshijnë: gjuhën, aktivitetet, mesazhet, kohën e programuar, numrin e pjesëmarrësve.	☐ ☐ ☐ ☐		
4.4 Nëse planifikohen vlerësimet përfundimtare: Vlerësimi shihet si një pjesë përbërëse dhe element i rëndësishëm për të siguruar cilësinë e programit. Përcaktohet se cili lloj vlerësimi është më i përshtatshëm për ndërhyrjen dhe planifikohet një vlerësim i zbatueshëm dhe i dobishëm. Specifikohen treguesit e rëndësishëm të vlerësimit, dhe përshkruhet procesi i mbledhjes së të dhënave.	☐ ☐ ☐ ☐		

Etapa e projektit 5: Menaxhimi dhe mobilizimi i burimeve

Një program për parandalimin e drogës konsiston jo vetëm në ndërhyrjen aktuale, por gjithashtu, kërkon një menaxhim të mirë të projektit dhe planifikim të detajuar për të siguruar se ai është i zbatueshëm. Gjatë krijimit të ndërhyrjes duhet të merren parasysh aspektet menaxhuese, organizative dhe praktike. Për të nisur implementimin, duhet të aktivizohen burimet në dispozicion dhe të vlerësohen burimet e reja sipas nevojës. Librat e referimit për menaxhimin e projektit ofrojnë një informacion të detajuar se si të planifikohet dhe të menaxhohet projekti. Megjithatë, së bashku me etapën e projektit 3: Formulimi i programit, këto standarde theksojnë disa vlerësime kryesore në lidhje me punën parandaluese për drogën.

5.1 Planifikimi i programit – Ilustrimi i planit të projektit: Një procedurë e dedikuar siguron se planifikimi dhe implementimi janë kryer sistematikisht. Një plan-projekti i shkruar dokumenton të gjitha detyrat dhe procedurat që janë të nevojshme për implementimin e suksesshëm të programit. Plan-projekti udhëzon implementimin duke ofruar një kuadër të përbashkët në të cilin mund të punojnë të gjithë anëtarët e stafit. Në fazat e më vona të projektit, konsultohet plani i projektit për të vlerësuar nëse programi është implementuar siç ka qenë i paracaktuar, dhe nëse ka nevojë për përshtatje.

Projekti duhet që gjithashtu të ilustrojë dhe të lidhë pjesët përbërëse kryesore të programit, të tilla si popullata në objektiv, qëllimet dhe objektivat, modelin teorik, vlerësimin e treguesve dhe etapave, aktivitetet dhe rezultatet. Kjo mund të kryhet duke përdorur modelin logjik. Seti i Burimeve të Parandalimit dhe Vlerësimit të EMCDDA (PERK) përfshin shumë shembuj se si të formulohet dhe të përdorim modelet logjike; mund të arrihet nga: <http://www.emcdda.europa.eu/publications/perk>

5.2 Planifikimi i kërkesave financiare: Duhet të përcaktohen kërkesat financiare (kostot) dhe kapacitetet (buxheti) i programit, për të vënë në kontekst burimet e nevojshme dhe në dispozicion. Kostoja nuk duhet të kalojë buxhetin që është (ose do të jetë në dispozicion) për programin. Nëse janë të nevojshme më shumë burime se ato që janë në dispozicion, plani financiar sqaron cilat fonde shtesë mund të jenë të nevojshme ose se si mund të nevojitet të përshtatet plani i projektit.

5.3 Ngritja e ekipit: Skuadra konsiston në njerëz të cilët punojnë në program (p.sh. menaxhim, shpërndarje, vlerësim të programit). Anëtarët e stafit, (duke përfshirë vullnetarët) duhet të zgjidhen në përputhje me kërkesat dhe nevojat ligjore të programit. Rolet dhe përgjegjësitë do të shpërndahen përkatësisht, duke garantuar se janë ndarë dhe kryer të gjitha detyrat e nevojshme nga personat më të përshtatshëm (dmth ata me kualifikime dhe/ose eksperiencë të përshtatshme). Kjo pjesë përbërëse duhet të shihet në lidhje me pjesën përbërëse C: Krijimi i stafit.

5.4 Rekrutimi dhe ruajtja e pjesëmarrësve: Rekrutimi i referohet procesit të përzgjedhjes së individëve nga popullata në objektiv, duke i njoftuar ata në lidhje me programin, duke i ftuar ata të marrin pjesë, duke i regjistruar ata, dhe duke i siguruar që të fillojnë ndërhyrjen (p.sh. pjesëmarrja në seancën e parë). Pjesëmarrësit duhet të rekrutohen nga popullata e përcaktuar në objektiv me një metodologji korrekte dhe në mënyrë etike. Ruajtja i referohet procesit të sigurimit se të gjithë pjesëmarrësit mbeten në intervenim derisa ai të ketë përfunduar dhe/ose qëllimet janë arritur (cilado është më e përshtatshme). Kjo është veçanërisht e rëndësishme për programet që nevojitet të përfshijnë pjesëmarrësit për një periudhë të gjatë kohe. Duhet të identifikohen pengesat për pjesëmarrje dhe të largohen për të siguruar se pjesëmarrësit mund të marrin pjesë dhe të përmbushin programin.

5.5 Përgatitja e materialeve të programit: Duhet të merren parasysh materialet të cilat janë të nevojshme për implementimin e programit, duke përfshirë materialet e ndërhyrjes (ku është e përshtatshme), instrumentet për monitorim dhe vlerësim, pajisjet teknike, mjedisin fizik (p.sh. njësitë e mbështetjes), etj. Kjo bën të mundur finalizimin e planit financiar, dhe ndërmarrjen e veprimeve për të siguruar materialet e nevojshme. Nëse përdoren materialet e intervenimit (p.sh. manuallet, filmat, faqet në web), ato duhet të jenë të cilësisë së lartë dhe të përshtatshme për përdoruesit që ju janë caktuar.

5.6 Ofrimi i përshkrimit të programit: Një përshkrim i programit me shkrim ofron një vështrim të qartë të programit. Ai krijohet në mënyrë që aksionerët e interesuar (p.sh. popullata në objektiv, financuesit, profesionistët e tjerë të interesuar) mund të marrin informacion në lidhje me programin përpara se të fillojë dhe/ose ndërkohë që është në vijim. Intervenimi dhe aktivitetet e tij duhet të

përshkruhen në detaje, megjithëse niveli i detajeve do të jetë në varësi të qëllimit të programit dhe lexuesve të mundshëm të programit. Nëse përshkrimi përdoret për rekrutimin e pjesëmarrësve, veçanërisht duhet të vihet theksi mbi riskun e mundshëm dhe përfitimin për pjesëmarrësit. Përshkrimi i programit ndryshon nga plani i projektit (i cili është një mjet i brendshëm për të drejtuar implementimin e programit) dhe nga raporti final (i cili përmbledh programin pasi ai ka përfunduar).

Kjo etapë mund të kryhet në të njëjtën kohë me planifikimin e ndërhyrjes.

5. Management and mobilisation of resources

Standardet bazë (përmbledhje):	Të papërbushura				Shënime mbi pozitën aktuale	Veprimet për t'u ndërmarë
	Pjesërisht të përbushura	Plotësisht të përbushura	E paaplikueshme			
5.1 Planifikimi i programit – Ilustrimi i planit të projektit: Për planifikimin sistematik të programit, koha lihet mënjanë. Një plan projekti i shkruar përvijon elementet dhe procedurat kryesore të programit. Janë krijuar plane të rastësisë.	☐	☐	☐	☐		
5.2 Planifikimi i kërkesave financiare: Është dhënë një përllogaritje e qartë dhe realiste e kostos për programin. Buxheti në dispozicion është i specifikuar dhe i përshtatshëm për programin. Kostot dhe buxheti në dispozicion janë të ndërlidhur. Menaxhimi financiar është në përputhje me kërkesat ligjore.	☐	☐	☐	☐		
5.3 Ngritja e ekipit: Stafi i nevojshëm për implementimin e suksesshëm është përcaktuar (dhe ka gjasa që) është në dispozicion (p.sh. tipet e roleve, numri i stafit). Ngritja e skuadrës është e përshtatshme për programin. Janë përcaktuar procedurat e përzgjedhjes së stafit dhe të menaxhimit.	☐	☐	☐	☐		

5. Menaxhimi dhe mobilizimi i burimeve (vijon)

Standardet bazë (përmbledhje):	Shënime mbi pozitën aktuale				Veprimet për t'u ndërmarë
	Të papërbushura	Pjesërisht të përbushura	Plotësisht të përbushura	E paaplikueshme	
5.4 Rekrutimi dhe ruajtja e pjesëmarrësve: Është e qartë se si tërhiqen pjesëmarrësit nga popullata në objektiv, dhe cilat mekanizma janë përdorur për rekrutim. Masat specifike janë ndërmarrë për të shtuar në maksimum rekrutimet dhe për të mbajtur pjesëmarrësit.	☐	☐	☐	☐	
5.5 Përgatitja e materialeve të programit: Janë specifikuar materialet e nevojshme për implementimin e programit. Nëse përdoren materialet e intervenimit (p.sh. manualet), informacioni i përdorur aty duhet të jetë i faktuar dhe i cilësisë së lartë.	☐	☐	☐	☐	
5.6 Ofrimi i përshkrimit të programit: Ekziston një përshkrim i qartë, i shkruar i programit dhe është (të paktën pjesërisht) i arritshëm nga grupet e rëndësishme (p.sh. pjesëmarrësit). Ai përbën elementet kryesore të programit, sidomos ndikimin e tij të mundshëm mbi pjesëmarrësit.	☐	☐	☐	☐	

Etapa e projektit 6: Dorëzimi dhe monitorimi

Në këtë etapë, planet e krijuara më parë vendosen në praktikë. Në këtë pikë, një çështje veçantë është nevoja për të ruajtur një balancë ndërmjet besueshmërisë (dmth përmbajtjes ndaj planit të projektit) dhe fleksibilitetit (dmth reagimi ndaj zhvillimeve të reja që dalin në sipërfaqe). Pjesët përbërëse përcaktojnë se si mund të arrihet kjo balancë duke pyetur për cilësinë dhe progresin e implementimit, dhe duke bërë modifikime të kontrolluara për të përmirësuar programin.

6.1 Nëse kryhet një ndërhyrje pilot: Në raste të caktuara, për shembull nëse është krijuar një ndërhyrje e re ose që duhet të kalojë nga implementimi lokal në atë kombëtar, fillimisht ndërhyrja duhet të testohet duke e implementuar atë në një shkallë më të ulët. Kjo ndihmon në identifikimin e çështjeve të mundshme praktike dhe pika të tjera të dobëta që nuk u bënë të dukshme gjatë planifikimit, dhe që mund të jenë tepër të kushtueshme të trajtohen pasi projekti të jenë plotësisht në zbatim. Një ndërhyrje pilot (ose studim pilot) është një provë në shkallë të ulët përpara zbatimit të plotë të tij (p.sh. me më pak pjesëmarrës, në vetëm një ose dy zona). Gjatë ndërhyrjes pilot, të dhënat e procesit dhe rezultatet (e kufizuara) mblidhen dhe përdoren për të kryer një vlerësim në shkallë të ulët. Duke përdorur nga piloti, krijuesit e programit mund të bëjnë ndryshime përfundimtare dhe të pakushtueshme në ndërhyrje përpara implementimit të saj aktual.

6.2 Implementimi i ndërhyrjes: Menjëherë pasi të ketë prova të mjaftueshme për të sugjeruar se ndërhyrja e planifikuar për parandalimin e drogës do të jetë efektive, e zbatueshme dhe etike, ndërhyrja implementohet ashtu siç është paraqitur në planin e projektit. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se i duhet përmbajtur në mënyrë të ngurtë ndaj planit të projektit nëse ka nevojë të dukshme për modifikim. Për të lehtësuar vlerësimet dhe raportimin e më vonë mbi programin, implementimi dokumentohet në detaje, duke përfshirë ngjarjet e paparashikuara, devijimet dhe dështimet.

6.3 Monitorimi i implementimit: Ndërkohë që zbatohet programi, të dhënat e rezultateve dhe procesit mblidhen dhe analizohen në mënyrë periodike, për shembull, në lidhje me rëndësinë e ndërhyrjes ndaj pjesëmarrësve, besueshmërinë ndaj projektit, dhe efektivitetin. Implementimi aktual i ndërhyrjes dhe aspektet e tjera të programit krahasohen me atë çfarë është përcaktuar në planin origjinal. Shqyrtimet e rregullta të progresit, ndihmojnë gjithashtu në identifikim, nëse ka nevojë për të modifikuar planin origjinal. Monitorimi siguron se implementimi është i cilësisë së lartë, por ai gjithashtu ju lejon ofruesve të përmirësojnë praktikën e parandalimit duke identifikuar dhe reaguar për kërkesat e ndryshuara ose shtesë, përpara se këto të paraqesin një kërcënim për suksesin e programit.

6.4 Përshtatja e implementimit: Implementimi nevojitet të mbetet fleksibël, në mënyrë që të mund të reagojë ndaj problemeve që dalin në sipërfaqe, ndryshimet e prioritetëve, etj. Aty ku është e nevojshme dhe e mundur, implementimi i programit duhet të përshtatet në përputhje me gjetjet nga monitorimi i shqyrtimeve. Megjithatë, modifikimet duhet të jenë minimale dhe të justifikuara mirë, dhe duhet të merret parasysh ndikimi i tyre i mundshëm negativ. Rrjedhimisht, nëse janë bërë ndryshime, ato duhet të dokumentohen dhe vlerësohen, për të kuptuar se çfarë ndikimi kanë pasur mbi pjesëmarrësit dhe suksesin e programit.

6. Dorëzimi dhe monitorimi

Standardet bazë (përmbledhje):	Të përmbyshura Pjesërisht të përmbyshura Plotësisht të përmbyshura E paaplikueshme	Shënime mbi pozitën aktuale	Veprimet për t'u ndërmarë
6.1 Nëse kryhet një ndërhyrje pilot: Një ndërhyrje pilot kryhet nëse është e nevojshme. Ajo duhet të merret parasysh, për shembull, kur implementohen ndërhyrje të reja ose tepër të adaptuara, ose kur programet kanë për qëllim propagandimin e gjerë. Gjetjet nga vlerësimi pilot përdoren për të informuar dhe përmirësuar implementimin e duhur të ndërhyrjes.	☐ ☐ ☐ ☐		
6.2 Implementimi i ndërhyrjes: Programi është implementuar në përputhje me planin e shkruar të projektit. Implementimi është dokumentuar në mënyrë të përshtatshme, duke përfshirë detajet mbi dështimet dhe devijimet nga plani origjinal.	☐ ☐ ☐ ☐		

6. Dorëzimi dhe monitorimi (vijon)

Standardet bazë (përmbledhje):	Të papërbushura	Pjesërisht të përbushura	Plotësisht të përbushura	E paaplikueshme	Shënime mbi pozitën aktuale	Veprimet për t'u ndërmarë
6.3 Monitorimi i implementimit: Monitorimi shihet si një pjesë përbërëse e fazës së implementimit. Të dhënat e rezultateve dhe procesit janë përmbledhur gjatë implementimit dhe janë rishqyrtuar sistematikisht. Gjithashtu shqyrtohen plani i projektit, burimet, etj. Qëllimi i monitorimit është të përcaktojë nëse programi do të jetë i suksesshëm dhe për të identifikuar çdo përshtatje të nevojshme.	☐	☐	☐	☐		
6.4 Përshtatja e implementimit: Fleksibiliteti është i mundur nëse kërkohet për një implementim të suksesshëm. Implementimi përshtatet në përputhje me gjetjet nga monitorimi, aty ku është e mundur. Çështjet dhe problemet trajtohen në një mënyrë e cila është e përshtatshme për programin. Përshtatjet janë të mirë-justifikuara, dhe janë dokumentuar arsyet për përshtatje.	☐	☐	☐	☐		

Lutemi t'i referoheni listës së plotë të standardeve bazë dhe eksperte në manualin EMCDDA kur kryeni vetë-reflektimin tuaj, shihni:

<http://www.emcdda.europa.eu/publications/manuals/prevention-standards>

Etapa e projektit 7: Vlerësimet përfundimtare

Pasi të jetë plotësuar ndërhyrja, vlerësimi përfundimtar diskuton rezultatet e tij dhe/ose procesin e ofrimit të ndërhyrjes dhe implementimin e programit. Shkurtimisht, vlerësimet e rezultateve fokusohen mbi ndryshimin e sjelljes tek pjesëmarrësit (p.sh. reduktimi i përdorimit të drogës), ndërsa procesi i vlerësimit fokusohet mbi rezultatet e aktivitetit (p.sh. numri i seancave të ofruara, numri i pjesëmarrësve të kontaktuar). Standardet në këtë fazë të projektit duhet të shihen në lidhje me komponentin 4.4, nëse planifikohen vlerësime përfundimtare, të cilat gjithashtu, vënë në dukje se cilat përgatitje janë të nevojshme për tu siguruar se të dhënat e rëndësishme të jenë mbledhur gjatë implementimit.

Tek komponenti 4.4 Nëse planifikohen vlerësime përfundimtare, manuali përmban një paraqitje të shkurtër për procesin dhe rezultatin e vlerësimit siç është e konceptuar në standarde, dhe ilustron sesi prirjet, qëllimet dhe objektivat specifike mund të formulohen dhe përkthehen në tregues vlerësimi dhe etapa.

EMCDDA ka publikuar gjithashtu *Udhëzuesin për vlerësimin e parandalimit të drogës* (e përditësuar në 2012), e cila përmban shembull të dobishëm se si të planifikohet dhe të raportohen aspekte të ndryshme të vlerësimit. Këto mund të gjenden në:

http://www.emcdda.europa.eu/publications/manuals/prevention_update

7.1 Nëse kryhet një vlerësim i rezultatit: Si pjesë e vlerësimit të rezultateve, të dhënat e rezultateve mbledhen në mënyrë sistematike dhe analizohen për të shqyrtuar se sa efektiv ka qenë implementimi. Të gjitha rezultatet duhet të raportohen ashtu siç përcaktohen në fazën e planifikimit (dmth në përputhje me treguesit e përcaktuar të vlerësimit). Në varësi të shkallës së programit dhe strukturës së kërkimit e cila është përdorur, duhet të kryhen analizat statistikore për të përcaktuar efektivitetin e ndërhyrjes në arritjen e qëllimeve të përcaktuara. Aty ku është e mundur, një deklaratë e thjeshtë mbi efektivitetin e ndërhyrjes përmbledh gjetjet e rezultatit të vlerësimit.

7.2 Nëse kryhet një vlerësim i procesit: Vlerësimi i procesit dokumenton se çfarë ka ngjarë gjatë implementimit të programit. Për më tepër, ai analizon cilësinë e dobisë së programit duke marrë parasysh kërkimin dhe mbulimin e tij, pranimin e ndërhyrjes nga pjesëmarrësit, implementimin e besueshmërisë dhe përdorimin e burimeve. Gjetjet nga procesi i vlerësimit ndihmojnë në shpjegimin e gjetjeve nga rezultatet e vlerësimit dhe për të kuptuar se si mund të përmirësohet programi në të ardhmen.

Gjetjet nga vlerësimi i rezultatit dhe procesi i vlerësimit duhet të interpretohen së bashku në mënyrë që të përftohet një kuptim i thellë i suksesit të programit. Kjo njohje do të informojë etapën përfundimtare të projektit 8. Propagandimi dhe përmasat.

7. Vlerësimet përfundimtare

Standardet bazë (përmbledhje):	Të papërbushura Pjesërisht të përbushura Plotësisht të përbushura E paaplikueshme	Shënime mbi pozitën aktuale	Veprimet për t'u ndërmarë
7.1 Nëse kryhet një vlerësim i rezultatit: Përmasa e mostrës mbi të cilën është bazuar rezultati i dhënë, dhe është e përshtatshme për analizim të të dhënave. Kryhet një analizë e përshtatshme e të dhënave, duke përfshirë të gjithë pjesëmarrësit. Të gjitha gjetjet janë raportuar në terma të matshme. Merren parasysh burimet e mundshme të dyshimit dhe shpjegimet për gjetjet. Vlerësohet suksesi i programit.	☐ ☐ ☐ ☐		
7.2 Nëse kryhet një vlerësim i procesit: Implementimi i programit është dokumentuar dhe shpjeguar. Vlerësohen aspektet e mëposhtme: përfshirja e popullatës në objektiv; aktivitetet; përhapja e programit; përdorimi i burimeve financiare, njerëzore dhe materiale.	☐ ☐ ☐ ☐		

Etapa e projektit 8. Propagandimi dhe përmirësimet

Në etapën finale të projektit, shqetësimi madhor është e ardhmja e programit: a duhet të vazhdojë programi, nëse po, si? Informacioni propagandues në lidhje me programin mund të ndihmojë në promovimin e vazhdimësisë së tij, por gjithashtu, ju bën të mundur të tjerëve të mësojnë nga eksperiencia e implementimit të programit.

8.1 Përcaktimi nëse programi duhet mbështetur: Në mënyrë ideale, një program me cilësi të lartë për parandalimin e drogës mund të vijojë përtej implementimit të tij fillestar dhe/ose pasi të jetë ndërprerë financimi nga jashtë. Përdorimi i evidencave empirike të prodhuara nëpërmjet monitorimit dhe vlerësimeve përfundimtare (në varësi se cilat të dhëna janë në dispozicion), është e mundur të merret vendim nëse ia vlen të vazhdohet programi. Nëse vendoset se programi duhet të mbështetet, duhet të specifikohen dhe zbatohen hapat e duhur dhe veprimet për vijimësinë.

8.2 Shpërndarja e informacionit në lidhje me programin: Shpërndarja mund të japë përfitime për programin në shumë mënyra, për shembull duke shtuar mbështetjen nga aksionerët e rëndësishëm për vazhdimësinë e tij dhe duke përmirësuar programin nëpërmjet informacionit vlerësues. Kjo i shtohet gjithashtu, bazës së evidencave or parandalimin e drogës, duke kontribuar si rrjedhojë në politikat e ardhshme të drogës, praktikën dhe kërkimet. Në mënyrë që t'ju jepet ndihmuesve të tjerë mundësia për të kopjuar ndërhyrjen, materialet e ndërhyrjes dhe informacione të tjera të rëndësishme (p.sh. informacioni për kostot) duhet që gjithashtu të vihet në dispozicion me sa më shumë detaje që të jetë e mundur (në varësi të kushteve të së drejtës së autorit, etj).

8.3 Nëse krijohet një raport përfundimtar: Raporti final është shembull i një produkti propagandues. Ai mund të krijohet si një regjistrim i implementimit, si pjesë e një marrëveshjeje financimi, ose thjesht për të informuar të tjerët rreth programit. Shpesh, raporti përfundimtar paraqet një përmbledhje të dokumentacionit të krijuar në fazat e hershme të projektit. Ai përshkruan shtrirjen dhe aktivitetet e programit, dhe, aty ku është në dispozicion, gjetjet nga vlerësimet përfundimtare. Duke qenë se jo gjithnjë kërkohet të ketë një raport përfundimtar dhe mjetet e tjera të propagandimit mund të jenë më të përshtatshme (p.sh. prezantimet me gojë), ky komponent është i rëndësishëm vetëm kur prodhohet një raport përfundimtar.

Kjo etapë mund të përfaqësojë fillimin e ciklit të një projekti të ri me qëllimin për përmirësimin dhe zhvillimin më tej të programit ekzistues.

8. Propagandimi dhe përmirësimet

Standardet bazë (përmbledhje):	Të papërbushura Pjesërisht të përbushura Plotësisht të përbushura E paaplikueshme	Shënime mbi pozitën aktuale	Veprimet për t'u ndërmarë
8.1 Përcaktimi nëse programi duhet mbështetur: Bazuar në evidencat e ofruara nga monitorimi i ofruar dhe/ose vlerësimet përfundimtare, merret vendimi nëse programi duhet të vazhdojë. Nëse ai duhet të vazhdojë, përcaktohen mundësinë për vazhdimësinë. Eksperiencat e fituara nga implementimi përdoren për të informuar aktivitetet e ardhshme.	☐ ☐ ☐ ☐		
8.2 Shpërndarja e informacionit në lidhje me programin: Informacioni mbi programin shpërndahet për audiencat e rëndësishme në një format të përshtatshëm. Për të mbështetur përsëritjet janë përfshirë detajet mbi eksperiencat e implementimit dhe rezultatet që nuk priteshin. Merren parasysh aspektet ligjore mbi programin (p.sh. e drejta e autorit).	☐ ☐ ☐ ☐		
8.3 Nëse krijohet një raport përfundimtar: Raportet përfundimtare dokumentojnë të gjitha elementet madhore të planifikimit të programit, implementimit, dhe (aty ku është e mundur) vlerësimin në mënyrë që të lexohet lehtë, të jetë i qartë dhe me rrjedhë logjike.	☐ ☐ ☐ ☐		

Vetë-reflektimi: plani i veprimit

Kjo faqe përmbledhëse ofron mundësinë për të përmbledhur gjetjet kryesore nga vetë-reflektimi dhe veprimet madhore që duhen ndërmarrë aktivitetet aktuale. Si referim për të ardhmen, është e rëndësishme që të shënohet se kur ndodhi reflektimi dhe cili u përfshi (ky mund të jetë një person ose, për shembull, skuadra e programit). Gjithashtu, duhet të specifikohet data për rishikimin e ardhshëm, dhe të shënohet në kalendar. Megjithatë standardet duhet të informojnë praktikën ditë-pas-dite, dokumentimi dhe arritja e standardeve zakonisht do të jetë një aktivitet jo i shpeshtë dhe i pazakontë. Sidoqoftë, është e rekomandueshme që lista e kontrolleve të rishihet në intervale të përshtatshme për të gjurmuar progresin dhe të përforcohet motivimi për përmirësime kur është e nevojshme.

Përmbledhja e gjetjeve kryesore dhe veprimeve që vihen në dukje nga vetë-reflektimi

Data e Rishikimit:

Rishikimi u krye nga:

Data tjetër e rishikimit:

Materialë të tjera për lexim

EMCDDA Qendra Evropiane e Monitorimit për Drogat dhe Varësinë nga Droga (1998), *Udhëzuesit për vlerësimin e parandalimit të drogës: një manual për planifikuesit e programit dhe vlerësuesit*, Luxembourg, Zyra e Botimeve e Bashkimit Evropian.

<http://www.emcdda.europa.eu/publications/manuals/prevention>

EMCDDA Qendra Evropiane e Monitorimit për Drogat dhe Varësinë nga Droga (2010), *Mjetet e Burimeve të Parandalimit dhe Vlerësimit (PERK). Një manual për profesionistët e parandalimit*. Luxembourg, Zyra e Botimeve e Bashkimit Evropian.

<http://www.emcdda.europa.eu/publications/perk>

EMCDDA Qendra Evropiane e Monitorimit për Drogat dhe Varësinë nga Droga (2011), *Standardet evropiane të cilësisë për parandalimin e drogës: një manual për profesionistët e parandalimit*, Manualet Nr. 7 të EMCDDA. Luxembourg, Zyra e Botimeve e Bashkimit Evropian.

www.emcdda.europa.eu/publications/manuals/prevention-standards

EMCDDA Qendra Evropiane e Monitorimit për Drogat dhe Varësinë nga Droga Portali i praktikave të mira

<http://www.emcdda.europa.eu/best-practice>

UNODC, Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (2013), *Standardet Ndërkombëtare për Parandalimi e Përdorimit të Drogës*, Vjenë, Kombet e Bashkuara.

<http://www.unodc.org/unodc/en/prevention/prevention-standards.html>

Shënim ligjor

Ky botim i Qendrës Evropiane të Monitorimit për Drogat dhe Varësinë nga Droga (EMCDDA) është i mbrojtur për të drejtën e autorit. EMCDDA nuk mban asnjë përgjegjësi ose detyrim për ndonjë pasojë që mund të lindë nga përdorimi i të dhënave që përmbahen në këtë dokument. Përmbajtja e këtij botimi nuk reflekton domosdoshmërisht qëndrimin zyrtar të partnerëve të EMCDDA, Shteteve Anëtare të EU ose ndonjë institucioni apo agjencie të Bashkimit Evropian. Kjo mund të arrihet nëpërmjet serverit të Evropës (<http://europa.eu>).

© European Monitoring Centre for Drugs and Drug Addiction (EMCDDA), 2013
Praça Europa 1, Cais do Sodré, 1249-289 Lisbon, Portugal
Tel. +351 211210200 • www.emcdda.europa.eu

Ky botim ekziston në gjuhën boshnjake, anglisht, kroatisht, maqedonisht, shqip, serbisht dhe turqisht. Gjuha origjinale – anglisht. Përkthimi në shqip është bërë nga Fatbardha Lama dhe i verifikuar nga Eduard Kakarriqi [Shefi i Departamentit të Epidemiologjisë dhe Sistemit Shëndetësor. Instituti i Shëndetit Publik – Shqipëri].

Të dhënat e katalogimit

Qendra Evropiane e Monitorimit për Drogën dhe Varësinë nga Droga
Standardet evropiane të cilësisë për parandalimin e drogës: një udhëzues i shpejtë
Luxembourg: Zyra e Botimeve e Bashkimit Evropian
2013 — 37 pp. — 21 x 29.7 cm
ISBN: 978-92-9168-668-1
doi: 10.2810.18829

TD-01-13-424-SQ-N